

Sabian Hasani është Drejtor i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore. Ai ka përfunduar studimet universitare Bachelor of Science në Arkeologji Klasike dhe Biologji, me një minor në Biofizikë, në Universitetin e Miçiganit, si dhe studimet pasuniversitare Master i Shkencave në Arkeologji në Universitetin e Tiranës. Me mbi 15 vite përvojë profesionale në fushën e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore, Sabiani ka qenë i angazhuar në projekte akademike dhe profesionale në Shqipëri, Itali dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjatë karrierës së tij, Sabian Hasani ka pasur rol drejtues në projekte dhe ekspedita arkeologjike akademike, përfshirë gërmime arkeologjike në Romë, Itali, për një periudhë 7 vjeçare, si dhe në projekte të mëdha infrastrukturore dhe zhvillimore në Shqipëri, në bashkëpunim me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Përvoja e tij përfshin drejtimin e ekipeve multidisiplinare, koordinimin institucional dhe zbatimin e standardeve shkencore dhe ligjore në dokumentimin, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore. Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së tij profesionale ka qenë e përqendruar në zhvillimin e nismave të arkeologjisë digjitale, përfshirë hartëzimin digjital, modelimin 3D dhe përdorimin e mjeteve vizuale si instrumente mbështetëse për dokumentimin dhe komunikimin e trashëgimisë kulturore.

Për një vit, Sabian Hasani ka shërbyer si Këshilltar i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ku ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në hartimin, koordinimin dhe ndjekjen e projekteve strategjike që lidhen me trashëgiminë kulturore, turizmin kulturor, bashkëpunimin ndërinstitutional, si dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të UNESCO-s dhe nismave të tjera ndërkombëtare në fushën e kulturës.

Gjatë kësaj periudhe, Sabiani ka qenë pjesë e programit LEAD Albania, përmes të cilit ka ndjekur trajnime të avancuara ndërkombëtare, përfshirë një *Executive Program* në Harvard Kennedy School, si dhe një trajnim në College of Europe në Brugge, të fokusuar në proceset e integritetit evropian dhe politikat e Bashkimit Evropian.

Në ushtrimin e përditshëm të funksionit të tij si Drejtor i IKRTK-së, Sabian Hasani ka një fokus të veçantë në digjitalizimin e trashëgimisë kulturore, duke besuar fort në rëndësinë e praktikave solide të dokumentimit, të plotësuar nga standardet më të larta të shpërndarjes së informacionit, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë, transparencës dhe përmirësimit të kuptimit të trashëgimisë kulturore nga publiku dhe komuniteti profesional.